



01 Nr. 443/26 Dt. 04.09.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008),), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit të nënshkruar mes Komunës së Prizrenit dhe Fondacionit Terre des hommes Lausanne në Kosovë, 01 nr. 367/26, të datës 07.08.2026 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin e projektit që ka për qëllim vazhdimin e bashkëpunimit mes palëve për ofrimin e shërbimeve të specializuara bazuar në modelet e zhvilluara nga TDHK, duke përfshirë por pa u kufizuar në: shërbimet për fëmijë në situatë rruge, shërbimet emergjente për fëmijë të cilët gjenden në rrezikshmëri të lartë, i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 2.2 lidhur me nenin 1 të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit të nënshkruar mes Komunës së Prizrenit dhe Fondacionit Terre des hommes Lausanne në Kosovë, 01 nr. 367/26, të datës 07.08.2026, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 45.000,00 € (katërdhjetë e pesëmijë euro).
2. Zyrtar përgjegjës për monitorimin e projektit, nga Komuna e Prizrenit caktohet Bashkim Rakaj.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëfinancimit të nënshkruar mes Komunës së Prizrenit dhe Fondacionit Terre des hommes Lausanne në Kosovë, 01 nr. 367/26, të datës 07.08.2026.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
5. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - TDHK,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

